



VENDIM

Nr. 990, datë 1.2.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, *“Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”*, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 11 datë 19.7.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit **“Zamir Gjeloshaj”**, protokolluar me nr. 4386 prot., datë 29.8.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën “a”/iii, të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, *“Për lejet e mjedisit”*. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 11, datë 19.7.2018, në vlerën 300.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

